



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “KOALICIONI
EUROATLANTIK” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Koalicioni Euroatlantik”, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025, administruar me nr. 1236 Prot., datë 24.02.2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vendimin e shkurtuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, i shpallur në datën 14.02.2025 dhe nuk ka marrë formë të prerë;

- a) Deklarata e angazhimit solem (Model KQZ-04-02);
- b) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezultojnë se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Koalicioni Euroatlantik” me shkronja nistore “KEA”, me adresë Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Endri Hasa, me adresë Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Jonida Bardhi, me adresë Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Ibrahim Sako, me adresë Rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Koalicioni Euroatlantik”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se dokumentacioni i paraqitur nga Partia “Koalicioni Euroatlantik” nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nenin 64 pika 2, gërma “a” e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se së bashku me dokumentet e kandidimit për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ “Vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor, Tiranë”.

Referuar dispozitave të sipërcituara, Partia “Koalicioni Euroatlantik” nuk e ka depozituar “Vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor, Tiranë”.

Licela VELIU	-Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Pavlina DOÇAJ	-Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA	-Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)